


E RËNDËSISHME!



Të dashur prindër,

për ne është shumë e rëndësishme që fëmijës tuaj t'i sigurojmë një arsimim bazë dhe ta bëjmë të aftë për jetën në komunitet.


Për këtë arsye, fëmija juaj dhe ne mësuesit kemi nevojë për *mbështetjen tuaj*.



Në vijim mund të lexoni se çfarë është e nevojshme që karriera shkollore e fëmijës suaj të jetë e suksesshme:

1. Ju lutemi blini **materialin shkollor sipas listës**.

Zakonisht mund ta paraqisni listën e materialeve shkollore në shitore.




2. Kontrolloni çdo javë nëse materiali shkollor është i plotë dhe blini çdo material që mungon nëse është e nevojshme.

Ju sugjerojmë që të keni një furnizim materialesh (lapsa, ngjitës, gomë, vizore, gërshërë ...) në fillim të vitit shkollor.



3. Kontrolloni çantën e shkollës çdo javë dhe zbrazeni kutitë e drekës dhe shishet e pijes çdo ditë. **Lodrat duhet të qëndrojnë në shtëpi.**



4. Sigurohuni që fëmija juaj **të shkojë në shtrat** herët (në ora 7 ose 8), përfshirë të dielat. Përndryshe është shumë e vështirë që fëmija juaj të ndjekë mësimin.



5. Mos harroni se shkollimi në Gjermani është i detyrueshëm.

Nëse fëmija juaj është i **sëmurë** dhe nuk mund të shkojë në shkollë, ju duhet të lajmëroheni në sekretari para orës 8 të mëngjesit. Ose përmes emailit (ESIS) ose përmes telefonit: 08131-754960.



Fëmija juaj nuk lejohet të mungojë pa miratimin e shkollës. Kjo vlen edhe për ditët para ose pas pushimeve shkollore.

6. Fëmija juaj duhet patjetër **të hajë mëngjes** para se të shkojë në shkollë. Në shkollë nuk ka mundësi të hajë mëngjes para mësimin.



7. Ju lutemi mos i jepni fëmijës tuaj Coca-Cola, pije me sheqer, çokollatë ose patate të skuqura me vete. **Për këtë ju mund t'i jepni ujë, fruta, perime, bukë (integrale) me gjalpë / djathë / ejt.**



8. Fëmija juaj ka të paktën **dy detyra shtëpie** për të bërë në ditë. Sigurohuni që fëmija juaj t'i bëjë ato në qendrën e kujdesit pas shkollës ose në shtëpi në një vend të qetë. Kërkoni nga fëmija juaj të ju tregojnë detyrat e përfunduara çdo ditë.



9. Kontrolloni e-mailet ose mesazhet tuaja në **ESIS** çdo ditë. Klikoni në "**përgjigje**" dhe "**dërgo**" kur të keni lexuar dhe kuptuar letrën e prindërve. Nëse e keni të vështirë ti kuptoni, ekziston mundësia që letrat e prindërve ti lexoni në **gjuhë të ndryshme** në faqen e internetit. Për ta bërë këtë, shkoni te zona "Downloads".

10. Kontrolloni **çdo ditë dosjen / fletoren e detyrave të shtëpisë të fëmijës suaj** për të parë nëse ka *informacione nga mësuesit*. Kushtojini vëmendje përgjigjeve - ju duhet të konfirmoni që e keni lexuar dhe kuptuar informacionin. Nëse nuk i kuptoni informacionet, ju lutemi kontaktoni mësuesin.



11. Nëse keni ndonjë problem ose pyetje, mund të kontaktoni punonjësen sociale të të rinjve Znj. **Sabine Decker!** Ajo është e pranishme në shkollën tonë çdo ditë dhe mund ta kontaktoni përmes telefonit në numrin 0151-54866196 ose përmers email jas-gs-ost@awo-dachau.de.



12. Do të ishte shumë e dëshirueshme të merrni pjesë në **mbrëmjet e prindërve dhe ditët e konsultimit**. Informacionet dhe data përkatëse do t'i merrni gjatë vitit shkollor. Ju gjithashtu mund të kërkoni një takim me mësuesin e fëmijës tuaj në çdo kohë.



13. Ju mund të pasuroni **atmosferën shkollore**, nëse vendosni të ndihmoni me: ëmbëlsira për festa, shoqërime gjatë ekskursioneve, aktivitete në klasë ... Për këto çështje ju do të merrni ftesa individuale.

